



Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA E KOSOVES
OPSTINA LIPJAN

Pranuar me: 31.07 2025		
Priljeto:		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
12-320/01-39693		



قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL DHE ORGANIZATA "QATAR CHARITY"

NJOFTIM

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Organizata "Qatar Charity" në kuadër të marrëveshjes së arriturë me nr.01/06/15400 të datës 22.07.2025 në komunën e Lipjanit, do të implementoj projekte në sektorin e bujqësisë konkretisht: montimin e **serrave bujqësore për kultivim** me sipërfaqe 96m2 (16m x 6m) me sistem të ujitjes, dhe projekti tjetër: **motokultivatorë me frezë dhe kosë**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriterët si:

- ✓ Të jetë banorë i Komunës së Lipjanit;
- ✓ Të ketë mundësi për ta realizuar projektin;
- ✓ Të ketë përshtatshmëri të vendit për realizimin e projektit në afërsi të shtëpisë;
- ✓ Përparësi kanë familjet që jetojnë në kushtet të rënda ekonomike;
- ✓ Përparësi kanë familjet të cilët nuk kanë përfituar më parë;
- ✓ Përparësi kanë familjet që jetojnë në zonat e thella.
- ✓ Ata të cilët nuk posedojnë serrë;
- ✓ Të drejtë aplikimi për **motokultivatorë me frezë dhe kosë** kanë vetëm ata që kanë përfituar më parë sera nga Qatar Charity ose nga Komuna.

Në kushte të barabarta përparësi do të kenë:

- Familjet me numër më të madh të antarëve;
- Familjet me asistencë sociale;
- Familjet me fëmijë jetim;
- Familjet me anëtarë që vuajnë nga sëmundje të rënda kronike apo invaliditet;
- Banorët e Komunës së Lipjanit të cilët jetojnë në zona të thella;

Dokumentet obligative për aplikim:

- Kërkesën e plotësuar për aplikim, me adresën e vendbanimit;
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën nga Gjykata Themelore, që dëshmon se aplikuesi nuk është nën hetime;
- Çertifikatën e Bashkësisë Familjare;
- Konfirmimin e të ardhurave (pasqyra bankare për periudhën kohore 6 muaj të fundit dhe/ose dokument zyrtar nga ana e institucioneve të vendit i cili vërteton se personi në fjalë është i pa-punë);



Komuna e Lipjanit



قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

Dokumentet shtesë për aplikim:

- Dokumente zyrtare kopje (*familjet me anëtarë që kanë sëmundje të rënda kronike apo ato me invaliditet*);
- Kartelën e ndihmës sociale kopje (*familjet me asistencë sociale*);

Marrja e aplikacioneve si dhe dorzimi i dokumenteve bëhet në Zyrën pritëse në Komunën e Lipjanit, prej datës 31.07.2025 deri me datën 15.08.2025 nga ora 08:00-16:00h.

Vëmendje:

- Këto grante janë të destinuara për familjet me kushte të dobëta ekonomike;
- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në një kopje dhe brenda periudhës së aplikimit, pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

Drejtori
Rexhëp Rexhepi

